

NGA BEOGRADI, ME DASHURI
Tregimi i ri nga Serbia



traduki ^T

Publikimi i kësaj vepre u mbështet nga TRADUKI, rrjet letrar, anëtarë të së cilit janë Ministria Federale për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare e Republikës së Austrisë, Zyra Federale për Punë të Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Këshilli artistik i Zvicrës Pro Helvetia, KulturKontakt Austria, Instituti Goethe, Agjensioni Slloven i Librit dhe Fondacioni S. Fischer.

NGA BEOGRADI, ME DASHURI

Tregimi i ri nga Serbia

*Përgatiti redaksia e Kompletit kulturor-
propagandistik «Beton»*

*Milosh Zhivanoviq, Sasha Iliq, Tomislav
Markoviq, Sasha Qiriq*

*Përkthyen:
Anton Berishaj
Fadil Bajraj
Shkëlzen Maliqi*

MM
Prishtinë, 2011

PËRMBAJTJA

Sasha Qiriq: Deri në fund të dhunës	7
Sasha Iliq: Elementi i pestë.....	13
Jeton Neziraj: Make books, no war	17
I Të mavijosur në fytyrë	21
Millosh Zhivanoviq: Porta	23
Barbara Markoviq: Dremitja.....	37
Enes Haliloviq: Loja	43
Sergej Stankoviq: Liria e re e tmerrshme.....	47
Ildiko Lovas: Kinemaja.....	51
Ivan Antiq: Shegerti i keq	57
II Porno banda	61
Mihajlo Spasojeviq: Akullorja.....	63
Nenad Jovanoviq: Glasë pëllumbi.....	71
Biljana Kosmogina: Porno star.....	81
Bojan Babiq: Bëhu e mirë, Julija	87
Dejan N. Kostiq: Edhe shëmtaket mëdyshen	91
Jordan Cvetanoviq: Nisja e aeroplanit	99
III Flamingot e kuqrrrema	115
Sllobodan Bubnjeviq: Përparimi.....	117
Andrija Matiq: Muzeu i artit bashkëkohor	125
Dana Todoroviq: nga «Fati tragjik i Moriq Totit»	133
Daniel Kovaç: Bisedat në park.....	141
Ivan Potiq: Fragmente	151
Sërgjan Srdiq: Mushkonjat	155
IV Sytë hapekrah të mbyllur.....	173
Gjergj Serbhorvat: Përndjekësi i ndjekur.....	175
Sërgjan V. Teshin: Tullumbat dhe vdekja	177
Borivoje Adasheviq: Për sunduesin e huaj	191
Jelena Gjokiq: Urbano ndëshkimor	199
Aleksandër Bjellogërlig: Efekti Prust	209
Sasha Iliq: Kuarti kinez.....	221

Sasha Qiriq
DERI NË FUND TË DHUNËS
4 fragmente mbi tregimet më të reja nga Serbia

1.

Zgjedhjen që e keni para jush quhet antologji, ndonëse bëhet fjalë për një panoramë ose prerje. Nuk bëhet fjalë për tregime më të mira, por për një varg tregimesh që prezantojnë më mirë se çfarë do të mund ose duhej të ishte tregimi bashkëkohor serb. Në fund të decenies së parë të mileniumit të tretë, në skenën letrare serbe antologjia *Nga Beogradi, me dashuri*, paraqet përzgjedhjen e parë përfshirëse të tregimeve bashkëkohore, e cila, pos me numrin e autoreve dhe autorëve të brezave të viteve '70 dhe '80 që përfaqësohen, shquhet edhe për nga synimi që të demonstron përzierja politike, dispersioni gjeografik, barazia gjinore dhe llojllojshmëria poetike e skenës aktuale letrare në Serbi.

Kjo antologji e ka kapacitetin e përfaqësimit të dyfishtë: që skenën e re të prozatorëve ta prezantojë te shqipfolësit në Kosovë dhe atje ku flitet gjuha shqipe (Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi...) si dhe që vetë mjedisit letrar në Serbi t'i tregojë se kush janë dhe çfarë janë tregimtarët më të rinj dhe ata të moshës së mesme të hershme. Në këtë edhe qëndron paradoksi i kësaj antologjie dhe situimi i saj alternativ kulturor-politik. Në fillim të shekullit 20, Bogdan Popoviq dhe Jovan Skerliq bënë prerje të ofertave të tyre poetike dhe prozatore për revistat letrare kroate, duke konfiguruar kështu arritjet dhe vlerat e letërsisë serbe të asaj kohe, por edhe duke forcuar lidhjet kulturore me një mjedis tjetër. Në këtë kuptim të dy antologjitë, edhe ajo e letërsisë shqipe në Kosovë, edhe e letërsisë serbe, mund të shënojnë një fillim të ri në komunikimin autentik kulturor mes dy mjedisëve, fillim që na relakson nga dhuna dhe diskriminimi që i kanë shënuar dhe ngarkuar marrëdhëniet mes dy mjedisëve tona. Kjo përzgjedhje mund të përjetohet veçanërisht si një projekt kontrapunkt ndaj ksenofobisë dhe autizmit

të ideologjisë nacionaliste që qëndron në prapavijën e modelit kulturor që dominon shumicën e shoqërive postjugosllave.

2.

Në kuadër të tregimit bashkëkohor që botohet në Serbi sot, temë e veçantë për analizë është shkrimi autorial femëror. Emrat e autoreve të brezit të vjetër dhe të mesëm të shkrimit femëror mund t'i identifikojmë nëse i marrim në dorë dy përzgjedhje të rëndësishme. Në antologjinë «Tragime femërore bashkëkohore serbe» *Kontinenti femëror (Ženski kontinent, Prosveta, 2004.)*, që është përgatitur nga Lilana Gjurishiq, pos vetë editores janë përzgjedhur këto autore: Judita Shalgo, Mirjana Pavloviq, Elvira Rajkoviq, Milica Miqiq Dimovska, Boba Blagojeviq, Ljubica Arsiq, Snezhana Bukal, Nina Zhivançeviq, Marija Ivaniq, Jelena Lengold, Danica Vukiqeviq, Marija Knezheviq dhe Divna Vuksanoviq. Nëse e krahasojmë këtë antologji me atë tjetrën reprezentative të shkrimit autorial femëror, antologjinë e Radmila Laziq *Macat nuk shkojnë në parajsë (Mačke ne idu u raj, Samizdat B92, 2000)*, mund të vërejmë dy gjëra: se procesi i kalimit të interesimit krijues nga poezia në prozë e ka kapluar po aq shkrimin femëror sa edhe atë mashkullor dhe se ky kalim ka ndodhur kryesisht gjatë viteve '90 dhe, me përjashtime të rralla, shkrimtaret bashkëkohore më të rëndësishme serbe janë sprovuar edhe në poezi edhe në prozë.

Është për të ardhur keq që tregimi femëror bashkëkohor serb nuk ka shumë autore. Autoret më të mira shkruajnë poezi dhe drama (Dragana Mlladenoviq, Milena Markoviq, Ana Ristoviq, Maja Peleviq, Bilana Srblanoviq, Marija Karaklajiq...) ose menjëherë kalojnë te romani (Barbi Markoviq, Ana Vuçkoviq). Nën ndikimin e mediave dhe të tregut, si dhe të traditës së fortë të shkrimit femëror komercial (Ljiljana Habjanoviq Gjuroviq, Gordana Kuiq, Mirjana Bobiq Mojsiloviq...) ndër autoret e reja ka mjaft epigone dhe vazhduese (Masha Rebiq, Dunja Radosavljeviq...)

Mund të thuhet se antologjia *Nga Beogradi, me dashuri* diskriminon pozitivisht shkrimin autorial femëror. Konsideronim se mundësia e evidenca e tërthortë në fizionominë dhe përmbajtjen e tekstualitetit autorial femëror vlen më shumë se përkatësia e brezit, librat e botuar apo tregimet e shkruara. Ndonëse Ildiko Lovash

shkruan në gjuhën hungareze dhe boton në një shtëpi botuese nga Sllovakia, rrathët tematik të prozës së saj i takojnë prozës në kontekstin aktual serb. Andaj proza e saj për nga njohja dhe estetika pasuron këtë kontekst dhe është një tregues më shumë për skenën serbe në tërësi. Te Barbi Markoviq dhe Dana Todoroviq përvoja jetësore dhe afiliacioni autorial, fryma e Bernhardt dhe Kafkës, në mënyrë interesante ndikon në dallimin e prozës së tyre në krahasim me ofertën aktuale të prozës në Serbi. Kjo vlen veçanërisht për eksperimentin *ready made* në romanin e Barbi Markoviq *Dalja* (*Izlaženje*, Rende, 2005). Në gjurmet e kësaj poetike eksperimentale qëndron edhe tregimi që prezentohet në këtë antologji, e cila i ofrohet leximit si skenim satirik-grotesk i psikologjisë kolektive të kryeqytetit austriak që është i prirur për t'u ndikuar nga hipnoza dhe manipulimi masiv. Bilana Kosomogina është e vetmja autore që ka libër me tregime të botuar, tregime që janë intencionalisht të profilizuara sipas matricave të zhanreve të narrativave erotike dhe pornografike që kanë thithur mjaft bizaritete inventive dhe ofrojnë një paletë të gjerë komike. Tregimi i Jelena Gjokiq i takon kronikave urbane të kryeqytetit dymilionësh e cila, nga këndi i një autsjadere cinike, shfrytëzon automjetet e trafikut urban, gjithnjë të shkërmoqura dhe të pista, duke bërë një premje socio-patologjike të përditshmërisë së Beogradit.

3.

Në cilin kontekst dhe mbi themelet e cilës traditë krijohet tregimi bashkëkohor serb? Me një fjalë, kontekstin bashkëkohor letrar në Serbi e përcakton kriza (kriza e botimit të revistave, mungesa e dukshme e librarive në shumë qytete të Serbisë dhe borxhet e rrjeteve të librarive ndaj botuesve që ndikon në zvogëlimin e vëllimit të botimeve) si dhe komercializmi i veprimtarisë së shtëpive botuese. Është ngushtuar dukshëm hapësira për botimin e dorëshkrimeve të shkrimtarëve të rinj (ka mbijetuar vetëm edicioni *Libri i parë* i Matica Srpska nga Novi Sadi), tregu dikton botimin e romaneve që kanë sadokudo gjasa që të shiten, revistat letrare nuk janë më instrument i gjenerimit të jetës letrare, të vendit ku botohen pjesët e dorëshkrimeve që janë në krijim e sipër dhe të edukimit të kritikëve. Për nga poetika, decenia e parë e mileniumit

të tretë në letërsinë serbe shënon mbizotërimin definitiv të ashtuquajturit referencialitet i ri dhe largimi nga strategjitë postmoderne të rrëfimit të viteve '90. Me përjashtim të prozës së David Albaharit dhe Svetislav Basarës, postmoderna serbe e viteve '90 në pjesën më të madhe ka përjetuar hipertrofim në autizëm politik dhe fiksionalizim të faktografisë.

Referencialiteti i ri shënon lënien e hapësirës labirint prej biblioteke dhe zbulimin e fushës së realitetit dhe historisë, që kërkon markim të sërishëm letrar. Gjatë '90-ve kanë ekzistuar dy valë të «ri-shënjesve» të reales, që pararendës i ka autorët e prozës së stilit të ri ose të valës së zezë në letërsinë serbe nga fundi i viteve '60 dhe fillimi i viteve '70 të shekullit 20. Valës së parë i takon proza e autorëve Srgjan Valareviq, Mileta Prodanoviç, Vuleta Zhariq, Zoran Qiriq, Milosh Komadina (*Instituti i kancerit*, 2003), Laslo Blashkoviç dhe Igor Marojeviq. Për dallim nga proza e realitetit, kjo prozë i shmanget baltës së paralagjeve të qyteteve provinciale, dhe personazheve që me dije, folje dhe me trup janë të hendikepuar, prozë ku ngandonjëherë dominon gjuha e narracionit dialektor. Valën e dytë e përbëjnë shkrimtarët e «Shekullit qençe» («Pseći vek», Beopolis, 2000), antologjisë që e ka përpiluar Sasha Iliq dhe ku pos tregimit të tij, janë përfshirë edhe ato të autorëve Srgjan V. Teshin, Uglesha Shejtinac, Mihajlo Spasojeviq, Nenad Jovanoviç dhe Borivoje Adasheviq.

Janë edhe dy tradita dhe praktika të tjera që shpesh përfaqësohen në prozën bashkëkohore në Serbi: shkrimi klasik fantastik (Aleksandar Gatalica, Zoran Zhivkoviç, Goran Petroviç, Jovica Aqin, Milen Alempijeviq) dhe proza metatekstuale postmoderne (Milenko Pajiq, Gjorgje Pisarev, Sava Damjanov, Vladan Matijeviq, Vladimir Tasiq, Sreten Ugriçiq). Duhet të përmenden edhe prozatorët satirikë, që janë të angazhuar kryesisht në mediat e shtypura dhe në web portalët (Miodrag Raiçeviq, Mirjana Gjurgjeviq, Tomislav Markoviç...).

4.

Përzgjedhja *Nga Beogradi, me dashuri* sjell tregimet e autorëve tashmë të afirmuar dhe poetikisht të profilizuar, por edhe të atyre që janë nisur drejt krijimit të opusit të tyre. Në krahasim me po-

etikat e prozës së brezit të kaluar të rrëfimitarëve serbë që u përmenden, tregimet që janë përzgjedhur për këtë antologji kryesisht vazhdojnë me mëdyshjet poetike që shkojnë nga përtëritja e referencialitetit kritik deri te loja e vetëqëllimshme autoreferenciale. Risia e tregimeve të reja është në atë që të gjitha, pa marrë parasysh se ku e kanë burimin poetik, janë të shënjuara, gati të stigmatizuara, me frymën e dhunës dhe të përjashtimit. Është interesant se kjo dhunë nuk manifestohet përmes narrativës së luftës, pos në tregimin «Për sunduesin e huaj» i cili në stilin arkaik të rrëfimit dhe me titullin që drejtëpërsëdrejti aludon evokimin e «keqpërdorimit të njeriut» për qëllime të pakuptimta të interesit shtetëror, dhe humbjen e shpresës dhe dështimin e individit me orientim pacifist. Dhuna megjithatë shprehet përmes urrejtjes dhe përleshjes fizike ndëretnike («Tullumbat dhe vdekja», «Ndjekësi i përndjekur»), ose urrejtjes mes brezave dhe mes rajoneve («Kuarti kinez»), ose interseksuale («Edhe shëmtaket mëdyshen», përdhunimi në tregimin «Porta»), ose mosdurimit ndërkulturor («Mushkonjat»). Por edhe përmes sulmit terrorist («Nisja e aeroplanit»).

Bota natyraliste e periferisë dhe mihjeve të minierave argëtohet me lojëra gladiatorësh të minjve të fushës («Loja»). Fryma zakonisht e hareshme postmoderne i nënshtrohet ose esencialisht dëmtohet me pamjet e destruksionit («Fragmentët») apo të dehumanizimit ku personaliteti i njeriut reduktohet në eksponat muzeal që po vdes dhe i ekspozohet voajerizmit nekrofil të vizitorëve («Muzeu i arteve bashkëkohore»). Për më shumë, edhe kujtesa e narratores së projeksionit kineast është e shenjësuar me pasojat e dhunës ideologjike dhe regresionit shoqëror nationalist («Kinemaja»). Nga ana tjetër, dhuna shfaqet edhe përmes paraqitjes së nihilizmit vleror. Fryma e indolencës themelore apo cinizmit pervers determinon botën e tregimit ku moskujdesi dhe pahiri për jetën e tjetrit jepen nga perspektiva e vetë subjektit të naracionit («Shegërt i keq»). Në një botë të tillë edhe pornografia e fëmijëve është biznes legal, kurse kodoshët rekrutohen edhe ndër kusherinjtë më të afërt («Bëhu e mirë, Julia»). Janë të ralla tregime si «Bisedat në park» që mbështjellat me nokturnin e fantazisë infantile dhe të prezentuar me vetëmjaftueshmëri të një humori benin, ose si në fillimin e romanit të Dana Todoqoriviq *Vdekja tragjike e Marica Tot*, ku narratori në kabinën e ngushtë të pëshpëritësit i mahnitur

dëgjon performansën e një opere në gjuhën italiane. Andaj është një «fitim i pastër» lëvizja nga narrativa pornografike në tregimin «Porno star», tregim ky që nuk është i vetëdijeshëm për prapavijën e tij apulejane, që, me një dozë të pritur të humorit, një yll animal të zoo-seksit e shndërron në genie të afërt dhe të dashur.

Spektri i melankolisë është vija e dytë e kuqe që i ndërlihd disa tregime të kësaj përzgjedhjeje. Këto tregime janë me kompozicion të ndërlikuar, të zhvendosura në kontekste azilantësh të Amerikës Veriore ose në sfondet e errëta të viteve inflatore '90 në Serbi, dhe të gjitha këto nga këndi mashkullor paraqesin përvojën e prishjes së lidhjeve shumëvjeçare dhe denimit me vetmi. Qoftë kur përmbajnë motive *bartonfinkiane* mbi anonimin që po bëhet shkrimtar, me referenca në krimet serbe në luftërat e viteve '90 («Akullorja»), qoftë kur përçudnojnë dhe shkrijnë dimensionet kohore dhe psikologjike të tregimit («Glasë pëllumbi») ose si insajderë ndriçojnë përpjekjet që përmes parapsikologjisë ta mbrojnë arsyen dhe të sigurojnë fushën e kërkimeve hermenautike («Efekti Prust»), këto tri tregime përmbajnë shmangie kritike dhe satirike nga vendi i prejardhjes dhe fryma e kohës. Në këtë *cajtgajst* (frymë e kohës) përputhen dimensionet e personale me ato kolektive dhe të dyjat bëhen shprehje e humbjes.

Përktheu: Shkëlzen Maliqi

Sasha Iliq

ELEMENTI I PESTË SHIKIM PËRBRENDA

Ka kaluar një dhjetëvjetësh prejse në produksionin alternativ të shtëpisë botuese Beopolis, në një numër të kufizuar të kopjeve, është botuar përmbledhja e përbashkët e 6 tregimtarëve (të lindur pas vitit 1970) me titullin *Shekulli qençe*. Ky libër, kuptohet, nuk është pritur mirë. Përkundrazi, e përcollën komente, si ai i paharrueshmi se po u bëka fjalë për «një brez që do të mund ta kishim». Disa kritikë e kujtuan pesë apo gjashtë vite më pas. Disa edhe më vonë. Shumica – kurrë. Jo rallë herë e kam pyetur veten për çfarë arsye skena letrare serbe reagoi ndaj nesh, mu në ata muajt kur ishte përmbysur regjimi i Milosheviqit (dhejtor 2000), në mënyrë aq arrogante. Në atë kohë nuk ekzistonte *Beton*-i¹ e as *E-novine*², dhe as *Peščanik*³ nuk merrej me tema letrare. Shtrohet pyetja çka ka mundur të jetë aq irrituese në *Shekullin qençe*. A nuk ka qenë më logjike që shkrimtarët e promovuar në atë përmbledhje të vogël të priten si një brez që megjithatë përjetoj vitet më të këqija të luftërave dhe fatkeqësive, duke ofruar disa përgjigje për problemet e të kaluarës së afërt? Por kjo nuk është e vetmja gjë në këtë rrëfim që të le pa mend. Shumë shpejt pas përmbledhjes ne do të botonim edhe librat tonë të parë me prozë, dhe edhe ata do të vlerësoheshin si «shlagerë» të panevojshëm, «literaturë vrimë që mbushet me budallaki të rikomponuara, rok e xhaz» si dhe me filma dhe «lustrim monumentesh». Kështu e lexonin prozën tonë përfaqësuesit e kritikës posmoderniste që gjatë viteve të nëntëdhjeta patën promovuar rrjedhat kryesore të literaturës në Serbi dhe u patën forcuar edhe më shumë pas vitit kthesë 2000. Si konformistë që ishin gjatë Milosheviqit, këta kritikë patën ndërtuar «perandorinë e fantazisë» që në letërsinë bashkëkohore serbe në

1 Shtojcë që botohet në gazetën *Danas*, redaktohet nga Sasha Iliq dhe Sasha Qiriq dhe bashkëpunëtorët. *Beton* është i njohur si botim që kultivon kritikë të pamëshirshme ndaj politikës dhe kulturës nacionaliste serbe.

2 Portal në Internet me orientim kritik ndaj politikave aktuale në Serbi por edhe rajon.

3 Emission dhe Blog cilësor në Portalin e B92.

prozë shtrihet nga Milorad Paviq deri te Goran Petroviq, dhe në poezi nga Ivan V. Laliq deri te Dragan Jovanoviq Danilov. Ka qenë kjo kohë e *pushtetit absolut të metaforës* që duhej t'i maskonte pamjet e skëterrshme të krimeve, dëbimeve dhe luftërave serbe në letërsia. Shkrimi konformist, si te kritika letrare ashtu edhe te vetë letërsia, e pat sjellë këtë brez buzë kollapsit, kështu që ai në fund, duke mos pasur shtegdalje, u derdh në *mainstream-in* e letërisë serbe, i cili që nga vitet e pasëdhjeta të shek. XX ishte nën kontrollin absolut të Dobrica Qosiqit. Kështu, në Serbine e viteve të nëntëdhjeta dhe të dymijëta vjen deri te krijimi i modelit letrar turbo-postmodern, i cili nënkuptonte ndërlidhjen e *tregimit sublim* me *nacionalizmin*, ndërkaq *vdekjen e tregimit të madh* e zëvendësonte tregimi mbi *rrezikun e madh që kanos serbët*. Ky fenomen edhe prodhoi atë simbiozën aktuale që kritiku më i njohur postmodern nga vitet '80 – Aleksandar Jerkov, të bëhet me grupin nationalist të shkrimtarëve më të rinj të brezit të mesëm, që njihen me emrin e përbashkët P70.

Nëse shikohet retroaktivisht, fitohet përshtypja se proza e *Shekullit qençe* as që ka mundur të pranohet më mirë në një skenë letrare, matricat kryesore të së cilës janë të orientuara drejt një horizonti kulturologjik krejt tjetër. Në atë horizont edhe një Mirko Kovaç del shkrimtar i rangut të dytë, Filip Davidi është fenomen letrar marginal, ndërkaq edhe Danilo Kish është një autor «që arriti sukses fal çifutërisë-masonerisë». Nga ana tjetër, establishmenti kulturor serb e ka pritur i mahnitur romanin *Istikami i hekurt* (Gvozdeni rov, 2004), që është i nënshkruar nga Milorad Ulemek Legija, atentatori i kryeministrit Zoran Gjingjiqi dhe komandant i njësitit për operacione speciale të policisë serbe. E pat botuar shtëpia botuese më e madhe në atë kohë – Narodna knjiga, e cila me vite të tëra aplikonte me sukses estradizimin e letërisë, duke e përdorur pa ngurrim popullizmin në retorikë vizuale dhe marketing. Kështu *Istikami i hekurt* u prodhua si një lekturë e politikës reformiste anti-Gjingjiq dhe apoteozë e luftërave të fundit, që arriti shitjen rreth 70 mijë kopje. Kur falementoi ky mastodont prej botuesi, që në themele kishte kapitalin jotransparent të Sigurimit shtetëror (DB) dhe JUL-it të Mirjana Markoviq,⁴ një pjesë e kuadrove redaktoriale

4 JUL – E Majta e Bashkuar Jugosllave, parti në krye të së cilës ishte Mirjana Markoviq, gruaja e diktatorit serb Slobodan Milosheviq. Pas përmbysjes së Milosheviqit në vitin 2000 dhe dërgimit të tij në Hag, Mirjana Markoviq arratisët në Moskë.

të saj u shpërngul në shtëpinë botuese shtetërore Službeni glasnik (Gazeta zyrtare), një pjesë tjetër u kthye në universitet, ndërkaq disa gjetën strehim në faqet e kulturës të publikimit më të rëndësishëm të elitës së mbijetuar të Milosheviqit – në javorën *Pečat*, drejtor i së cilës është Milorad Vuçeliq, kurse redaktor Aleksandar Vulin, që të dytë bashkëpunëtorë të ngushtë të çiftit sundues të dikurshëm. Është interesante përputhja e politikës kulturore të kësaj reviste me politikën redaktuese të Gazetës zyrtare, të cilën e udhëheqin disa funksionarë të lartë të Partisë Demokratike, përndryshe respektues të veprës dhe të praktikës politike të Dobrica Qosiqit. *Shtylla e tretë* e politikës kulturore të Serbisë është çmimi i NIN-it, të cilin sot (janar 2011) e kryeson Vasa Pavkoviq, redaktor i mëhershëm i *Narodna knjiga* dhe kritik letrar i revistës *Pečat*. As pjesa tjetër e jurisë nuk është larg këtij pozicioni ideologjik.

Nga gjashtë autorët e *Shekullit qençe*, pesë janë edhe në antologjinë *Nga Beogradi, me dashuri*:

Srgjan V. Teshin, Borivoje Adasheviq, Nenad Jovanoviq, Mihajlo Spasojeviq dhe unë. Në dhjetë vitet e fundit secili prej nesh ka botuar nga disa libra, në total 26 vëllime (duke llogaritur edhe produksionin e Uglesha Shajtinac). Nga këto vëllime 7 janë romane, 9 libra me tregime, 3 me drama, 4 përmbledhje me poezi, 1 libër esesh, 1 libër me korrespondencë dhe 1 libër me prozë për fëmijë. Pos kësaj mbetet edhe produksioni eseistik i vëllimshëm që gjendet i shkepur në botimet periodike dhe gazeta. Mirëpo, gjithë ky produksion asnjëherë nuk është pranuar si letërsi që ia vlen të merret parasysh, por sistematikisht anashkalohej. Disa nga librat tonë janë pranuar shumë më mirë në rajon se në Serbi. Temat që i kemi trajtuar para së gjithash kanë qenë të lidhura me shkatërrimin e Jugosllavisë, me shkaqet dhe pasojat e luftës, pastaj me krimet, diskursin nacionalist dhe të urrejtjes, represionin politik, dhunën, fatin e emigrantëve dhe të grupeve marginale, dramet individuale, deri te shembja e përditshme transicionale e sistemit. Disa nga këto tema lexuesit do t'i gjejnë edhe në tregimet që i kemi futur në këtë përzgjedhje (*Glasë pëlumbash*, *Për sunduesin e huaj*, *Tullumbat dhe vdekja*, *Akullorja*, *Kuarti kinez*).

Kur patëm nisur t'i mbledhim tregimet për këtë antologji, na u duk e natyrshme që të nisemi nga *Shekulli qençe* dhe qarku i autorëve që tubohen rreth shtojcës *Beton*, të cilin e redaktojmë në

kuadër të gazetës ditore *Danas* një herë në muaj. Kemi provuar të gjejmë edhe zërat e atyre shkrimtarëve dhe shkrimtareve të rinj që në mënyrë më të mirë mund të artikulojnë atë që mainstreami letrar serb e markon si *e përendësishme, më pak e vlefshme dhe e tepërt*. Kështë kemi ardhur deri te tregimet e shkëlqyera të hungarezve nga Vojvodina (Ildiko Lovash, Gjergj Serbhorvat) dhe boshnjakëve nga Sanxhaku (Enes Haliloviq), deri te proza e shkëlqyer queer (Bilana Kosmogina, Jordan Cvetanoviq), deri te letërsia e emigrantëve të rinj (Barbi Markoviq), apo e azilantëve të brensdhëm (Sergej Jankoviq, Ivan Antiq, Igor Potiq si edhe shumë të tjerë), përgjithësisht deri tek ata zëra që në këtë antologji fituan rastin e veçantë për prezentim jashë matricave *rreptësisht të kontrollura* të Serbisë.

Ashtu sikur që *Shekulli qençe* dhe *Betoni* asnjëherë nuk janë pranuar në Serbi, as kjo antologji, nëse do të botohej në gjuhën serbe, nga shumica nuk do të pritej mirë. Kjo gjithësesi ia rrit kapacitetin receptues jashtë kufijve. Nuk shtrohet fare pyetja pse është kështu. Çka është ajo që në këto tregime tejkalon llogorenë elementare regresive të produksionit bashkëkohor serb, që në mënyrë autiste mbyllet në vete? Më bie në mend filmi futurist i Luc Bessonit *Elementi i pestë*, i cili trajton rrëfimin *bllokaterian* mbi të ligën ultimative që shfaqet çdo pesë mijë vjet duke u përpjekur që ta përfundojë deri në fund punën e tij arketipe: që drita të shndërrohet në terr dhe jeta në vdekje. Rezistenca ndaj zezonës së këtillë ka qenë e mundshme vetëm përmes zbulimit të elementit të pestë, përkatësisht përmes një komponenti që elementeve bazike (uji, zjarri, ajri dhe toka) ua jep kuptimin sublim me një fuqi të pamimagjinueshme. Ky element i pestë ishte, në të vërtetë, përfaqësuesja femërore e species njerëzore, në interpretimin e Milla Jovoviq.

Do të thosha se tregimet që janë përfshirë në antologjinë *Nga Beogradi, me dashuri*, e kanë një element të pestë të tyre, i cili para së gjithash pasqyrohet në nevojën njerëzore të të kuptuarit të ndërsjelltë me Tjetrin. Shpresoj se lexuesit kosovarë do të mund ta gjejnë këtë element në tregimet e reja nga Serbia.

Beograd, janar 2011

Përktheu: Shkëlzen Maliqi

Jeton Neziraj
MAKE BOOKS, NO WAR

E njëmend është provokim i qëllimshëm. Ideja për këtë titull të kësaj antologjie të prozës së re serbe që do të botohej në Kosovë doli në Beograd, në një ndejë diku rreth mesit të natës. U përmend “Bambi”, u përmend “Boro e Ramizi”, u përmend “Zastava”, u përmendën kallashnikovët, “vëllazërim- bashkimi” e shumëçka tjetër... Por, s`e di kush (unë kam qejf të besoj që isha unë ai) dha idenë që kjo antologji të kishte këtë titull: “*Nga Beogradi, me dashuri*”. E pokështu, antologjia e letërsisë së re shqipe e cila po botohet në Serbi, të ketë titullin “*Nga Prishtina, me dashuri*”. Make love, no war! Paj, jo bash në këtë variant patetik. Dëshëm diçka që mund të dukej krejt normale, por që në të njëjtën kohë të ishte thellësisht cinike. E çka ka më normale sesa dashuria? E, në anën tjetër, çka ka më cinike sesa të thuash se diçka mund të ardhka në Kosovë ‘*Nga Beogradi, me dashuri*’. E gjithashtu, çka ka më cinike se sa të thuash se diçka mund të ardhka në Serbi ‘*Nga Prishtina, me dashuri*’. Qoftë kjo edhe një libër letërsie!

Në këto marrëdhëniet tona, Kosovë – Serbi, e anasjelltas, vetëm dashuria mungon! E po, ka munguar dhe mungon edhe shkëmbimi i letërsisë. Si gjithçka tjetër, edhe shkëmbimi i letërsisë ka qenë i tabuizuar. Atje: “Saçuvaj nas bože! Po librat e tyre ne i kemi djegur deri në një, para pak vitesh, si bëhet që tani u dashka t`i përkthejmë në gjuhën tonë të bukur serbe? Këtu: “Zoti na ruajt”, po librat e atyre t`mallkuar i kemi hequr prej banesave me thasë dhe i kemi hedhur në kontejnerë bërlloku para disa vitesh, si bëhet që tani u dashka t`i përkthejmë në gjuhën tonë të bukur shqipe!

Dhe meqë jemi te djegia e librave dhe te kontenjerët, dua të rikujtoj me këtë rast disa *histori librash*. Në fillim të 90-ve, në

shtëpinë time, në një paradite të bukur me diell, në zjarrin që po piqte flinë, axha im dogji një kallabllëk libra, për të cilët thoshte se 'janë për t`u djegur'. E merrni me mend, ishin libra për Titon, për Markisn, Leninin... Por e la pa djegë Rosa Luksemburgun, që s`i duket, nuk i tingëllonte aq temrrshëm, nuk i tingëllonte aq *komunizmisht*. Thua që pastaj, mbas kësaj flake, do t`ishim të lirë, të lumtur... Thua që, mbas kësaj djegie të këtyre librave, me zjarrin e flisë, po përmbylej një kaptinë historie, një kaptinë e keqe. Thua se, kështu po mbyllej përgjithmonë një mallkim. Të keqes digjia librat.

Intermexo

Viti 1997 ose 1998. Para Bibliotekës Universitare në Prishtinë, jo larg bustit të Vuk Karaxhiqit. Një traktor ngarkonte librat shqip nga biblioteka a Fakulteti Filozofik aty afër dhe i niste në rrugë pa kthim... Të keqes nisja librat me traktor në rrugë pa kthim.

Pak vite më vonë, në Prishtinë, në vitin 1999. Përfundimi i luftës. Shqiptarët ktheheshin në shtëpitë e tyre, serbët iknin. Ishte koha kur uzurpoheshin banesat e serbëve që po braktisnin Prishtinën. Për shumkë ishte legjitime të uzurpoje një banesë të një serbi; *ata kanë djegë shtëpitë tona, ne tash ua marrin të tyret*. Por, s`është ky thelbi i historisë që dua të tregoj unë. Kjo është histori librash. Ato ditë kontejnerët e Prishtinës ishin të mbushur me libra në serbisht. Shtretërit, karriget, tavolinat e bukës, thikat, pirunjët, uturakët e kakës, letra e toaletit, rrobet, jorganët, topat e ping-pongut, qorapet, radiot, këpucët, brushat e dhëmbëve e shumë e shumë gjëra të tjera serbe në ato banesa edhe mund të mbeteshin për t`u përdorur nga pronarët e rinj, pos... POS, jo librat. Librat duhej zhdukur. Duhej djegur (e meqë veq kishte pasur shumë zjarre në luftë, duhej të shpikëj diçka tjetër). Të keqes, digjia librat. Jo, jo, jo djegë. Të keqes, hidhja librat në kontejnerë bërlloku.

Tani, mbas kaq shumë vitesh, kur duket që njerëzit kanë filluar t`i harrojnë shprehjet e djegies së librave ose të hedhjes së librave në kontejnerë, ne kemi marrë guximin të fillojmë t`i shkëmbejmë sërish librat me njëri-tjetrin. Me shpresën që njerëzit do t`i lexojnë. Së paku, mbase, do t`i lexojnë para se t`i hedhin në kontejnerë.

Këto tregime të autorëve të rinj serbë që po i botojmë në këtë antologji janë faqja tjetër e asaj Serbie që njohim ne këtu në Kosovë.

Letërsia është ana njerëzore e një shteti. Shkrimtarët janë si zbutësit e kafshëve të egra. Herë duke e përkëdhelur e herë duke e goditur me kamxhik, ata e zbusin kafshën e cila pritët që më nuk do të kafshojë a shqelmojë askë.

Për fund...

Nuk mund të lë pa i falënderuar dy redaktorët e këtij botimi, Sasha Iliq dhe Sasha Qiriq, përkthyesit Anton Berishaj e Fadil Bajraj për këtë përkthim kaq të dinjitetshëm të këtyre tregimeve dhe natyrisht, Shkelzen Maliqin e Naile Imamin, për përkthimin e antologjisë tjetër serbisht, atje në Beograd.

Me Sasha Iliq kemi pasur kontakte të vazhdueshme tash e thujë një vit. Besimin që këto dy antologji do të botoheshin nuk e kemi humbur asnjëherë, megjithatë, ka pasur momente kur krejt kjo dukej si një *'mision i pamundur'*.

E, s`mund të lë pa përmendur Alida Bremer nga TRADUKI, e cila na ka shoqëruar në këtë ëndërrë për këto dy antologji.

Make books, no war.

Prishtinë, 15 janar 2011.